

REPUBLICA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA MINISTRI E ARSIMIT E SHKENCËS DHE E TEKNOLOGJISË MINISTARSTVO OBRAZOVANJA NAUKE I TEKNOLOGJIE MINISTRY OF EDUCATION, SCIENCE & TECHNOLOGY SEKTORI I ARKIVËS-SEKTOR ARCHIVE-ARCHIVE SECTOR	
Njësia Org. Org. Jedinica Org. Unit	01B
Nr. Prot. Broj Prot. Prot. No.	3923
Nr. i faqeve Br. stranica No. pages	2
Data: Datum: Date:	27.11.2024
Prishtinë / Pr	



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit/
Ministarstvo Obrazovanja i Nauke, Tehnologije i Inovacija / Ministry of Education, Science,
Technology and Innovation

Numër: 01B-210
Data: 27.11.2024

Kabineti i Ministrit/Kabinet Ministra/Cabinet of the Minister

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, në mbështetje të neneve 8, 10 dhe 11 të Ligjit Nr. 06 / L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtare Nr. 7/01 mars 2019), nënparagrafit 1.5 i paragrafit 1 të nenit 11 të Ligjit Nr.08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare /Nr. 34/18 nëntor 2022, Prishtinë), nenit 32 paragrafit 4 të Ligjit Nr. 04/L-037 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës, (Gazeta Zyrtare Nr. 14/9 shtator 2011, Prishtinë), nënparagrafit 1.4 nenit 4, shtojcës 1 pikës 7 të Rregullores (QRK) Nr. 14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive dhe nenit 9 të Udhëzimit Administrativ 20/2023 të datës 04.08.2023 për Krijimin e Skemave për Mbështetje Financiare të Studentëve për Ndarjen e Bursave, nxjerrë:

VENDIM

Për shpalljen e thirrjes për ndarjen e bursave për studentët e nivelit Bachelor jashtë vendit për vitin akademik 2024-2025

1. Lejohet shpallja e thirrjes për mbështetje financiare në nivelin bachelor jashtë vendit për vitin akademik 2024-2025, për studentët që janë të regjistruar apo vijnë studimet në nivelin bachelor në top 100 universitetet më prestigjioze në botë sipas listës "Times Higher Education".
2. Obligohet Departamenti i Arsimit të Lartë të shpallë thirrjen për mbështetje financiare bachelor jashtë vendit për vitin akademik 2024-2025.
3. Të drejtë aplikimi kanë studentët nga Republika e Kosovës të cilët studiojnë jashtë vendit në të gjitha fushat e studimit.
4. Shuma e bursës është 5000 euro (pesë mijë euro).
5. Vendimi hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetim

Duke u mbështetur në dispozitat e cekura më lartë dhe në zbatim të Udhëzimit Administrativ Nr. 20/2023 të datës 04.08.2023 për Krijimin e Skemave për Mbështetje Financiare të Studentëve për Ndarjen e Bursave, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi u dërgohet:

1. Kabinetit të Ministres;
2. Zyrës së SP;
3. DALSHT/MASHTI;
4. Arkivit.

